



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

*Komuna e Rahovecit/Opština Orahovac/Municipality Rahovec*

	REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC KABINETI I KRYETARIT TE KOMUNES/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET	
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit & Komunës)		
Nr./Br./No 02/04/2019 Nr. i faq/Bashk./No pg. 5		
Dha/Datum/Date 24/09/2019		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

Kryetari i Komunës/Presednik Opštine/Municipal Mayor

Në bazë të nenit 11 dhe 12.2 shkronja c), nenit 17 shkronja i) dhe nenit 58 shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës 28/2008”), Dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, Dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2018 për Transparencë në Komuna, Dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standartet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna dhe nenit 12 paragrafi 2 pika 2.1 të Statutit të Komunës së Rahovecit është përgatitur;

## Strategjia Avokuese për komunën e Rahovecit

Strategjia është ndihmuar dhe zhvilluar me kontributin e çmuar të grupit punues të përbërë nga përfaqësues të Komunes së Rahovecit dhe Syri i Vizonit:

- Afrim Dina, Kryesuesi i Kuvendit Komunal
- Qëndresa Duraku, Kabineti i kryetarit
- Saranda Sallku, Drejtoria e Administratës
- Njomeza Fazliu, Drejtoria për buxhet dhe Financa
- Sylejman Daka, Drejtoria për Sherbime Publike
- Haziz Krasniqi, Zyra e informimit
- Mirsad Shala, Zyrtari ligjor
- Sihëna Duraku, Shoqeria civile

Shtator 2019

## **Përbajtja:**

### **1. Përbledhje mbi dokumentin strategjik avokues**

### **2. Analiza e gjendjes aktuale**

### **3. Objektivat e strategjisë Avokuese**

### **4. Përgjegjësit e komunikimit të brendëshëm dhe të jashtëm**

**4.1** Për komunikim të brendëshëm janë përgjegjës zyrat e protokollit të secilit derpërtament.

**4.2** Për komunikim me ublikun janë përgjegjës: kryetari, nënkryetari, kryesuesi i kuvendit, zyra për informim me publikun, zëdhënësi i komunës, Shefi i kabinetit, zyra për Marrëdhënie me Publikun, drejtorët e drejtorive, shefat e sektorëve dhe persona të autorizuar.

### **5. Aktivitetet kryesore të strategjisë Avokuese**

**5.1** Ndërmjetësimi për pjesëmarrje të qytetarëve.

**5.2** Balancimi i pritjeve të qytetarëve me mundësitë reale financiare të komunës.

**5.3** Raportet në mes të komunës dhe shoqërisë civile të avancohen më tutje.

**5.4** Ndërtimi i raporteve të komunikim në mes të rindërvive dhe menaxhmentit të komunës së Rahovecit.

**5.5** Pjesëmarrje e qytetarëve në përpilim të buxhetit vjetor-dëgjim publik.

**5.6** Menaxhimi kërkeseve të qytetarëve përmes zyrës informuese dhe lehtësuese për qytetarët.

**5.7** Ofrimi i iniciativave (shpërblimeve për zyrtar dhe qytetar aktiv).

### **6. Aktivitete themelore për zbatimin e strategjisë**

### **7. Faza para implementimit**

### **8. Kontrolli i implementimit të strategjisë Avokuese**

- 8.1** Grupi punues për përgatitjen e Strategjisë Avokuese do të bëjë edhe imnlementimin e këtij dokumenti.
- 8.2** Të krijohet një grup monitorues i cili përpos anëtarëve të grupit punues të strategjisë, të përfshihen nga një përfaqësues i se cilin drejtori në kuadër të komunës.
- 8.3** Komuna e Rahovecit në kuadër të subvacioneve të OJQ-ve, do të hartojë thirjet e ndarjave të subvacioneve për OJQ-të, dhe do të nxisë të gjitha grupet për të aplikuar me projekte në bazë të objektivave të strategjisë avokuese të komunës.

## **1. Përbledhje mbi dokumentin strategjik Avokues**

Me iniciativë të organizatës jo-qeveritare nga Peja Syri i Vizionit (SiV) e me përkrahjen e Olof Palme InternationalCentre-OPIC dhe në bashkëpunim me komunën e Rahovecit, është hartuar StrategjinëAvokuese për zbatimin e Strategjisë së Komunikimit për komunën e Rahovëcit. Qëllimi i përgjithshëm i kësaj strategjie avokuese është të krijoj rrethana të reja për angazhim aktiv të qytetarëve dhe palëve të interesuar në vendim marrje, duke aplikuar qasje gjithëpërfshirëse dhe përdorur të gjitha mjetet moderne të komunikimit në dispozicon. Strategjia avokuese ka parasysh mundësitë e kufizuara financiare të kuvendit komunal të Rahovecit dhe për këtë arësyte është fokusuar në strategji avokuese që kanë kosto të ulët të zbatimit.

Grupi punues kishte në dispozicion 15 ditë pune për të zhviluar strategjinëavokuese të mbështetur në Strategjinë e Komunikimit tashmë të aprovuar që nga vitit 2016. Grupi punues është takuar gjatë 3 punëtorive ditë dhe ka zhvilluar konsultimet ditore të planifikimit dhe zhvillimit të kësaj strategjie avokuese në periudhën Mars - ..., 2019. Ndërsa gjatë tri ditëve tjera punë në punëtori direkte, konsulenti sëbashku me grupin ka përbeldhur mëndimet dhe opinionet e grupit punues të cilat i ka inkuadruar në këtë strategji. Ndërkohë aktivitetet e para është kryer vlerësimi për nevojat e komunikimit, me objektivin për të kuptuar praktikat aktuale të komunikimit. Zyrtarët komunal në mënyrë proaktive kanë marrë pjesë në diskutime të hapura për gjendjen aktuale sa i përket komunikimit dhe kontakteve me qytetar dhe kanë dhëne kontributin e tyre të çmuar për të dizajnuar këtë dokument. Në grupin punues kanë marrë pjese zyrtar të komunës së Rahovecit, përfaqësues të shoqërisë civile dhe përfaqësues të OJQ Syri i Vizionit.

## **2. Analiza e gjendjes aktuale**

Komuna e Rahovecit nëpërmjet ligjeve dhe rregulloreve mundëson pjesëmarrijën e qytetarëve në vendim marrje. Komuna në mënyrë aktive dhe të rregullt ka bërë përpjekje për të mbajtur kontakte dhe të angazhoj qytetar në vendim-marrje. Janë përdor metoda standarde të komunikimit sikur që janë postimet në vendet e përcaktuara për informim, takimet e drejtëpërdrejta në mes të kryetarit të komunës dhe qytetarëve. Kryetari i komunës vazhdon të

mbajë takime të drejtëperdrejta me qytetar në ditën e Enje përfshi edhe gjatë diteve tjera të javës. Poashtu, komuna ka organizuar tubime publike të parapara sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës Nr.1005 të datës 23.03.2019, Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Rregullorë Komunale për Transprence dhe Planit Komunal të Veprit të Transparency 01-Nr.1429 të datës 30.04.2019. Përkudër përpjekjeve, komuna konsideron se komunikimi ka nevoj të rritet dhe përmirësohet nëpërmjet pjesëmarrjes qytetare në vendimmarje e diskutim të drejtëpërdrejtë me komunën. Lidhur me këtë, për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në vendim-marrje dhe komunikimin sa më efektiv, komuna ka punuar me këshillat e fshatrave, ku gjithashtu komuna tashme tri vite ka edhe strategjinë e komunikimit dhe kontaktimit me qytetarët.

Sikur edhe në komunat tjera, ndër shkaktarët kryesor për performance jo të kënaqshme të këshillave të fshatrave konsiderohet se është mungesa e kompenzimit financiar që ata e kërkojnë cila ndikon drejtëpërdrejtë në punën dhe nivelin e angazhimit të tyre.

Me udhëzimin e ri i cili është duke u përgatitur e që ka të bëjë me bashkëpunim në mes të komunës dhe këshillave të fshatrave kryetarët e lagjeve dhe fshatrave do të kenë pagesë për punën e tyre.

Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme të komunës për të ngritur komunikimin me qytetar, mbetet edhe shumë punë për t'u bërë për të arritur rezultatet e dëshiruara. Qytetarët e Rahovecit vazhdojnë të jenë jo mjaftushëm aktiv rrëth zhvillimeve në Komunë dhe rrëth saj, gjithashtu pjesëmarrja është e nivelit të ulët sa i përket aktiviteteve dhe proceseve për të cilat qytetarët kanë edhe obligim të përgjigjen thirjeve të komunës, aty ku diskutohet dhe preket interesit i qytetarëve. Disa nga faktorët kryesor që ndikojnë që lajmet dhe informatat të mos arrijë tek qytetarët është mungesa e mediumeve lokale, mungesë e televizionit lokal në komunën e Rahovecit, mungesa e shërbimeve postale nëpër fshatra. Gjithashtu, sektori i pa zhvilluar i shoqërisë civile në komunën e Rahovecit po ndikon që komunimi në mes të qytetarëve dhe komunës të mos jetë i nivelit të dëshiruar. Për më tepër, edhe bizneset nuk marrin pjesë në debatet dhe takimet publike që janë në interest të përbashkët.

Në përgjithësi, komuna e Rahovecit ka zbatuar praktika për pjesëmarrjë të qytetarëve që janë treguar si jo tësuksesmedhe jo efektive për të ndërmjetësuar në pritet e qytetarëve dhe mobilizimin e tyrë për të marrë pjesë në vendim-marrje. Kjo ka ndikuar në nivel të lartë të mos pjesëmarrjes së tyre të cilët në përgjithësi ndihen të dekurajuar përfaktin se konsiderojnë se edhe nëse marrin pjesë, mendimet e tyre nuk kanë asnjë ndikim në vendimarrje.

Komunikimi me qytetar dhe palë të interesuara kërkon më shumë bashkërendim të ndërsjellë në mes të gjithë drejtoreve dhe strukturave komunale, pa dallim si dhe koordinim dhe bashkëpunim me sektorin jo-qeveritar dhe komunës në anën tjetër. Autoritetet komunale duhet të bashkërendohen në mënyrë që t'i arrijnë synimet. Kjo kërkon shkallë të lartë të efikasitetit në komunikim, si dhe aplikim të metodave të menduara më mirë, që kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë shërbimeve dhe qeverisjes. Komuna e Rahovecit synon të ndërrmer hapa serioz për të përmirësuar komunikimit me qytetar, duke ndryshuar edhe qasjen dhe strategjinë e kontaktimit të

qytetarëve.

Strategjia e avokimit qe është hartuar, involvon një angazhim të përbashkët pune, të gjithë hisedarët, autoritetet dhe qytetarët, konkretisht grupet e organizuara dhe individët, që të gjithë së bashku punojnë në një proces nga i cili do dalë dokumenti që përfshin interesat dhe qëndrimet e të gjithë palëve. Me aprovin e këtij dokumenti, përfituesit do kenë qasje më të lehtë dhe komunikim më të mirë më komunën. Kjo nënkuption në radhë të parë shoqërinë civile, mediat, komunitetet e caktuara dhe grupet joformaler, por edhe qytetarët individualisht, të cilët janë përfitues.

### **3. Objektivat e strategjisë Avokuese**

Strategjia Avokuese e komunës së Rahovecit mundëson dhe siguron arritjen e këtyre objektivave:

- Përmirëson në vazhdimësi marrëdhëniet midis qeverisë lokale, kuvendit komunal, qytetarëve, medieve, organizatave private dhe publike, organizatave joqeveritare, si dhe komuniteteve që jetojnë veprojnë në komunën e Rahovecit.
- Ngrijet vetëdijen, interesimin dhe pjesëmarjen e qytetarëve të komunës së Rahovecit në aktivitetet e qeverisë komunale dhe në proceset e vendimmarjes.
- Mundëson që qytetarët të marrin informacionin në mënyrën që ata dëshirojnë ta pranojnë.
- Eliminon pengesat të cilat ndikojnë që qytetarët të mos komunikojnë me anëtarët e qeverisë lokale dhe të zgjedhurit e kuvendit komunal.
- Ndërton lidhje efektive midis komunikimit dhe teknologjisë informative në mënyrë që të reduktohet kosto dhe koha e shpenzuar për përcjelljen apo pranimin e informacionit karshi qytetarit.
- Mundëson identifikimin e hershëm të iniciativave, çështjeve, projekteve dhe përcjelljen e informacionit të hershëm tek qytetarët, në mënyrë që ata të kenë mundësi të reagojnë shpejt duke dhënë vërejtjet, sugjerimet apo mendimet e tyre.

**Në vijim, janë paraqitur disa nga praktikat të komunikimit me qytetarët përmes fushatave avokuese dhe senezibilizuese.**

#### **Komunikimi me publikun:**

Diskutimet Publike-Mbledhje të obliguara me publikun ku diskutohet për çështjet që i brengosin qytetarët e komunës së Rahovecit.

Diskutimet publike për buxhetin-Takime mekryetarët e lagjeve dhe fshatrave, organizatat joqeveritare, organizatat sportive, grupet e grave, komunitetet e ndryshme për të dëgjuar nevojat

dhe pritet e tyre për ndarjen e buxhetit për vitin në vijim dhe përfshirja e tyre në prioritetet e komunës.

Pjesëmarrja në konferenca të shoqërisë civile dhe komuniteteve tjera-Përfaqësues të qeverisë lokale marrin pjesë në takime, tryeza, konferenca dhe seminare të organizuara nga organizatat joqeveritare dhe komunitetet tjera.

Organizimi i fushatave vetëdijesuese-Nëpërmjet sektorëve të caktuar, varësisht prej çështjeve që preokupojnë më shumë qytetarët, organizohen fushata të vetëdijësimit në bashkëpunim me shoqërinë civile.

Mbledhjet e sektorëve me trupa këshilldhënës-Sektorëtkrijojnë trupa këshilldhënëse për fusha të caktuara të shoqërisë dhe mbajnë mbledhje periodike sipas planit tëpërbashkët tëpunës.

Përpilimi dhe publikimi i kalendarit vjetor-komuna, respektivisht udhëheqësit në ekzekutiv dhe legjislativ përpilojnë dhe publikojnë kalendarin vjetor të aktiviteteve të planifikuara nëpërmjet veglave? përkatëse.

Takime me këshilla lokale-Komuna takon kryetarët e lagjeve dhe fshatravesë paku dy herë në vit për të paraqitur arritjet, sfidat dhe planet e komunës si dhe për të marrë nga ata propozimet për projektet e nevojshme për atë mjeshtë komunitet.

Njoftim për vizita zyrtare-Komuna nëpërmjet Shefit të kabinetit, Zyrës për marrëdhënie me publikun dhe zyrës për komunikim njofton rregullisht mediet dhe monitoruesit ndërkombëtarë me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi për vizitat zyrtare me rëndësi publike dhe kur vlerësohet si relavante, ju bën edhe ftesë zyrtare për pjesëmarrje.

#### **4. Përgjegjësit e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm**

**4.1** Për komunikim të brendshëm janë përgjegjëse zyreprotokolare të secilit departament.

**4.2** Për komunikim me publikun, në emër të komunës së Rahovecit janë përgjegjës:  
kryetari i komunës, nënkyetari i komunës, kryesuesi i kuvendit komunal, , zyra për informim me publikun, zëdhënësi i komunës, shefi i kabinetit dhe zyra për Marrëdhënie me Publikun,drejtoret e drejtive, shefat e sektorëve, personat e autorizuar nga kryetari, kryesuesi i kuvendit dhe nga drejtoret e drejtive.

## **5. Aktivitetet kryesore të strategjisëavokuese**

### **5.1 Ndërmjetësimi për pjesëmarrje të qytetarëve**

Organizimi i vizitave të përbashkëta me kryetarin e komunës Shefi i kabinetit, zyra për Marrëdhëniet me Publikun, zyren për informim dhe OJQ-të ku vizitojnë lokacionet e ndryshme për të diskutuar me qytetar lidhur me rëndësinë e pjesëmarries, idnetifikimi I prioriteteve të tyre, dhe zotimi përfshirjen e prioriteteve në prioritetet e qeverisë lokale.

Strategjia mediale: njoftim në facebook, foto, deklaratë për shtyp, përmes organizatave të shoqërisë civile.

### **5.2 Balancimi i pritjeve të qytetarëve me mundësitë reale financiare të komunës**

Drejtoret e ndryshme, asambleist organizojnë takime të drejtëpërdrejta me qytetar, dëgjimet publike, realozojnë vizita me qytetarët me qëllim të informohen saktë dhe janë të vetëdijshëm për mundësitë reale të komunës ku gjithashtu qytetarët kanë mundësinë të shohin drejtëpërdrejtëpolitkat buxhetore komunale dhe mundësite e tyre reale.

Strategjia mediale: postim në facebook, njoftim për media etj.

### **5.3 Raportet në mes të komunës dhe shoqërisë civile të avancohen më tutje**

Forcimi i raporteve të bashkëpunimit me organizatat e shoqërinë civile të gjitha nën-sektorëve (të rinjë, gra, personave me nevoja të veçanta) nëpërmjet takimeve, tryezave degjimeve publike, fushatave të ndryshme avokuese etj. Kyqja nëaktivitetet dhe programe të përbashkëta komunale dhe joqeveritare.

Strategjia mediale: foto, facebook, web faqe e komunës, web faqe të OJQ-ve

### **5.4 Ndërtimi i raporteve të komunikim në mes të rinjëve dhe menaxhmentit të komunës së Rahovecit**

Takime të drejtëpërdrejta me grupe të vogla të rinjëve.

Takimet e drejtëpërdrejta me të rinjë në zonat ku jetojnë.

Komuna ndërmerrë fushatë të gjërë të informimit, propozonjë ide/projekt, grumbullon të rinjë në tre lokacione dhe dizajnon projekt me idea dhe prioritete te rinjëve.

Krijimi i shembujve të mirë të bashkëpunimit dhe komunikimit në mes të rinjëve dhe komunës duke orgnaizuar fushata vetëdijësuese për të rinjtëdhe mbi rëndësinë e pjesëmarries së tyre active në proceset vendimarrëse.

Strategjia mediale: facebook, Webfaqe, foto.

## **5.5 Pjesëmarrje e qytetarëve në përpilim të buxhetit vjetor-dëgjim publik**

Sëbashku me grupet e të rindjeve, Organziatat e shoqërisë civile organizojnë vizita në fshatra dhc lagje të komunës së Rahovecit për të rritur numrin e pjesëmarrësve në dëgjimet publike me qëllim të përfshihen idetë dhe nevojat e qytetarëve në mënyrë sa me të mirë të mundshme. Tëorganzohen takimeve të drejtëpërdrejta me të rindjtë organizatat grat dhe grupet sportive për propozimet e tyre për buxhetin e vitit të ardhshëm.

Strategjia mediale: publikimi në portale lokale, transmetimi në radio lokaledhe postim live në facebook rrjedhën e diskutimit.

## **5.6 Menaxhimi kërkesave të qytetarëve përmes zyrës informuese dhe lehtësuese për qytetarët**

Me mbështetje tëkryetarit të komunës, drejtorisë së Administratës së Përgjithshme dhe zyrtarëve tjerëkomunal do të hapet zyra ndërlidhese mes qytetarëve dhe institucioneve lokale, e cila pranon dhe ndihmonëdrejtpërdrejtnë hartimin dhe përpilimin e kërkesave-ankeave dhe prioriteteve të qytetarëve. Qytetarët mund të kërkojnë ndihmëtë drejtëpërdrejtpër kërkesat-ankesat dhe nevojat e tyre, si dhe kjo zyre ndihmon në lehtësimin e komunikimit mes të qytetarëve-kryetarit dhe drejtorive përkatëse.

## **5.7 Ofrimi i iniciativave (shpërblimeve për zyrtar dhe qytetar aktiv)**

Stimulim të pjesëmarrjes nga ana e qytetarëve dhe nxitjes së saj nga ana e zyrtarëve, duke organizuar mirënjojje për zyrtarin e zellshëm që arrin të nxit pjesëmarrjen në vendimarrje dhe përmirson komunikimin me qytetar. P.sh qytetarët aktiv iu ipet kartelë me mirënjojje nga komuna si qytetar aktiv, i ulen taksat komunale simbolikisht si shenjë mirënjojje. Komuna vendos emrin e qytetarit në faqen e saj në internet dhe facebook, web faqe si qytetar aktiv.

Strategjia mediale: Komuna njofton qytetarët edhe përmes zyres së qytetarëve, se qytetari më aktiv do të shpërblehet nga komuna.

## **6. Aktivitete themelore për zbatimin e strategjisë**

- Identifikimi i nevojave përzhvillim të kapaciteteve përzbatuar planin strategjik të komunikimit si dhe strategjisë avokuese.  
(mund të zbatohet pararelisht edhe gjatë kohës derisa implementohet strategjia).
- Zhvillimi i planit të veprimit përzbatimin të strategjisë së komunikimit e cila mbështetet edhe nga strategjia avokuese.
- Përcaktimi i bartësive të strategjisë avokuese dhe nismëtarë

pëzbatimittestrategjisësëkomunikimit.

- Për zgjedha e përfaqësuesve të këshillave të fshatrave bazuar në kritere të jenë apolitik, profesional ndikimit dhe respektit që gjëzojnë në rrethin e tyre.
- Ngirja e vazdueshme e kapaciteteve të prezantimit publik dhe komunikimit, për zyrtarët e komunikimit dhe të gjithë atyre që kanë për mandate zbatimin e kësaj strategjie.
- Ndarja e buxhetit për zbatimin e strategjisë së komunikimit dhe kontaktit me qytetar dhe strategjisëavokuese
- Shpërndarja e draftit të gjithë hisedarëve për ta komentuar dhe për të dhënë kontributin e tyre në kuadër të kësaj strategjie avokuese.
- Shpërndarja e informatës për takime me publikun duket të përdor të gjitha mjetet.
- Përfshirja e të gjithëakterëvedhe informimi i drejtë i tyre (Grupet e interest, të rinjtë, grat, burrat, OJQ-të, sektorin publiko privat, bezinesetetj).
- Mbësthetja dhe hapja e zyrës për informim dhe ndihmëpalëve.
- Mbështetja e iniciativave avokuese të grupeve të grave asambleiste dhe grupeve jo formale të grave.
- Mbështetja e iniciativave të grupeve të ndryshme sportive, duke inkurajuar pjesëmarrjen e tyre nëaktivtete të rëndësishme qeveritare dhe lokale.

## **7. Faza para implementimit**

- Njofimi i personelit të komunës për lansimin e strategjisëavokuesdhe sigurohuni se secili zyrtar dhe departament përgjegjës për zbatimin e këtij dokumenti, është mirë i informuar dhe përgaditur. (takim me të gjithë palët përgjegjëse).

## **8. Kontrolli i implementimit të strategjisë Avokuese**

- 8.1** Grupi punues për përgatitjen e Strategjisë Avokuese do të bëjë edhe monitirimin e implementimit tw strategjisw nga tw gjithw akterwt.
- 8.2** Të krijohet një grup monitorues i cili përpos anëtarëve të grupit punues të strategjisë, të përfshihen nga një përfaqësues i secilin drejtori në kuadër të komunës.
- 8.3** Komuna e Rahovecit ne kuadër të subvencioneve të OJQ-ve, do të hartojë thirjet e ndarjave të subvencioneve për OJQ-të, dhe do të nxisë të gjitha grupet për të aplikuar me projekte në bazë të objektivave të strategjisë avokuese të komunës.

**Vërejtje:** Sa i përket implekimeve buxhetore dhe vijave buxhetore të kësaj strategjie, të gjitha shpenzimet që janë të parapara në kuadër të buxhetit janë të hartuara në vija të trasha, dhe të cilat do të implentohen në partneritet me partnerë të shoqërisë civile, dhe donatorë të jashtëm të cilet punojnë dhe organizojnë aktivitetetë me qëllime të përbashkëta.

Gjithsesi kjo strategji nuk obligon komunen e Rahovecit për të hartuar kod të veqantë buxhetor, pasi që të gjitha linjat do të jenë të implementueshme në kuadër të aktivitetetë të gjitha drejtorive si dhe në fonde shtesë të Shoqërsië civile dhe të donatorëve të ndryshëm.

SHTRAVIMI			
1 Ndërmjetësimi për pjesëmarrje të qytetarëve			
Aktiviteti	Kosto	Sasia	Nëntotali Euro
Organizimi I vizitave të përbashkëta	50	3	150
SHTRAVIMI			
2. Balancimi i pritjeve të qytetarëve me mundësitë reale financiare të komunës			
Aktivitetet	Kosto	Sasia	Nëntotali
Takimet e drejtëpërdrejta në mes të zyrtarëve të komunës/drejtorive dhe qytetarëve	/	/	
Radio debate-pjesëmarrës zyrtar dhe asambleist	300	2	600
Takimet e drejtëpërdrejta të Asambleistëve dhe qytetarëve në fshatra	/	/	
SHTRAVIMI			
3.Raportet në mes të komunës dhe shoqërisë civile avancohen më tutje			
Aktivitetet	Kosto	Sasia	Nëntotali
Realizimi I fushatave avokuese	1,000	3	3,000
Forcimi i raporteve të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile të gjitha nën-sektorëve (të rinjë, gra, personave me nevoja të veçanta) nëpermjet takimeve. <i>Takime në hapësirat e komunës, Vizita në zyre e OJQ-ve.</i>	50	9	450
SHTRAVIMI			
4.Ndërtimi i raporteve të komunikim në mes të rinjëve dhe menaxhmentit të komunës së Rahovecit			
Aktivitetet	Kosto	Sasia	Nëntotali
Takime të drejtëpërdrejta me grupe të vogla të rinjëve.	50	3	150
Takimet e drejtëpërdrejta me të rinjë në zonat ku jetojnë.			
Komuna ndërmerri fushatë të gjërë të informimit, propozonjë ide/projekt, grumbullon të rinjë në tre lokacione dhe dizajnon projekt me idea dhe prioritete te rinjëve.	200	300	600
SHTRAVIMI			
5.Pjesëmarrje e qytetarëve në përpilim të buxhetit vjetor-dëgjim publik			
Aktivitetit	Kosto	Sasia	Nëntotali
Për të përfshi idetë dhe nevojat e qytetnë mënyrë sa me të mirë të mundshme. Takime të drejtëpërdrejta me qytetar. Propozime të qytetarëve për buxhetin e vitit të ardhshëm. Takimet mbahen në të gjitha lokacionet e komunës dhe fshatrave.	30	35	1.050
SHTRAVIMI			

## 6. Menaxhimi kërkesave të qytetarëve në forme elektronike

Aktiviteti	Kosto	Sasia	Nentotali
Me mbështetje të zyrtarëve komunal do të hapet zyra ndërlidhese mes qytetarëve dhe institucioneve lokale, e cila pranon dhe ndihmonëd direct në hartimin dhe përpilimin e kërkesave dhe prioriteteve të qytetarëve. Qytetarët mund të kërkojnë ndihmë direkte për kërkesat dhe nevojat e tyre, si dhe kjo zyre ndihmon në lehtësimin e komunikimit mes të qytetarëve dhe drejtoreve përkatëse.	/	/	/

## STRATEGJIA

### 7. Ofrimi i incentivave (shpërblimeve për zyrtar dhe qytetar aktiv)

Aktivitetet	Kosto	Sasia	Nentotali
Mirënjohje për zyrtarin e zellshëm që arrin të nxit pjesëmarrjen në vendim- marrje dhe përmirëson komunikimin me qytetar. P.sh qytetarët aktiv iu ipet kartel me mirënjohje nga komuna si qytetar aktiv, i ulen taksat komunale simbolikisht si shenjë mirënjohjeje. Komuna vendos emrin e qytetarit në facebook, web faqe si qytetar aktiv.	/	/	/

Kryetari i Komunës së Rahovecit



Smajl Latifi